Orioni: një konstelacion i famshëm

Që nga kohërat e vjetra, popujt u kanë dhënë emra konstelacioneve – kryesisht emra kafshësh ose perëndish – dhe kanë krijuar legjenda mbi to.

Për shembull, konstelacionit që sot e njohim si Orion i është dhënë emri nga grekët e lashtë. Mitet e tregojnë Orionin si një gjysmëzot shumë të pashëm.

Astronomët e vjetër kinezë Orionin e njihnin me emrin Shen, gjahtar dhe luftëtar i madh.

Edhe shumë më përpara, egjyptianët e lashtë e lidhnin këtë konstelacion me zotin e tyre Osiris.

Popujt e parë që i dhanë një emër këtij konstelacioni ishin Sumerianët; emri ishte Uru An-na, që do të thotë ` Drita e qiellit '.

Shpesh konstelacionet paraqiten në flamujt e shteteve, gjë që provon rëndësinë e qiellit për njerëzit edhe në kohët moderne.

Në 1927 u mbajt një konkurs për të zgjedhur flamurin e Alaskës. Fituesi ishte Benny Benson, një djalë 13 vjeçar nga Alaska. Ai shkroi: `Ylli i Veriut është për shtetin e ardhshëm të Alaskës, më veriori në SHBA. Ariu është për Arushën e Madhe — që simbolizon fuqi '.

Flamuri i Brazilit me 27 yjet që paraqesin 27 shtetet e tij. Yjet janë orientuar në të njejtën formë si në qiellin e natës mbi Brazil.



Yjet e konstelacionit të Orionit, me vijat imagjinare që i lidhin.

Sipër: Orioni siç është paraqitur në 1687 nga astronomi polak Johannes Hevelius, në Atlasin e Qiellit të punuar prej tij.



Djathtas: një detaj nga harta Dunhuang, një atlas kinez i shek. 7, që tregon konstelacionin e Orionit.

Konstelacionet dhe Astronomia

Me sy të lirë mund të shihen disa mijra yje. Nëpër vite, ato janë futur në katalogët e shumë atlaseve qiellore, me ilustrime të bukura që paraqesin konstelacionet.

Sot astronomët e dinë si të matin largësitë e yjeve. Në të njëjtin konstelacion, yjet janë zakonisht shumë larg nga njeri-tjetri dhe nuk kanë asnjë lidhje fizike. Por ne ende na pëlqen t'i shohim ato bashkë në konstelacione.

Me teleskopë, ne mund të gjejmë shumë më tepër yje. Në 2014, duke përdorur teleskopin Isaac Newton në ishujt Canary, astronomët publikuan një katalog me 2 19 milionë yje.

Qielli në stinë të ndryshme

Yjet mund të shihen vetëm natën: ditën pamja e tyre verbohet nga Dielli.

Gjatë një viti, Toka sillet rreth Diellit, kështu që në stinë të ndryshme shihen pjesë të ndryshme të qiellit (shiko vizatimin në faqen tjetër).

Sfera qiellore është një sferë imagjinare me qendër në Tokë, ku yjet projektohen dhe duket sikur lëvizin mbi të.

Rruga e dukshme e Diellit në sferën qiellore është një rreth që përshkon ato konstelacione, të cilat ndodhen pranë planit të rrotullimit të Tokës rreth Diellit. Kjo rrugë quhet Zodiak.



Toka sillet rrotull Diellit. Përgjatë një viti, nuk shohim të njejtat konstelacione në qiellin e natës.



Njerëz që rrinë në dy hemisferat e kundërta të Tokës janë të përmbysurit e njëri-tjetrit, dhe po kështu i kanë të përmbysura edhe pamjet e të njejtit konstelacion.



Dinjakët



Luani



Akrepi



Mjelma

Disa konstelacione të njohura

Figura në qiell

Universi në xhepin tim

TUIMP
THE UNIVERSE IN MY POCKET
No. 5
Grażyna Stasińska
Observatori i Parisit

Orioni « kokëposhtë »

Mitet e kulturave të tjera janë krejt ndryshe.

Për Yollngu, një popull aborigjen nga Australia, Orioni është një kanoe me tre vëllezër që kishin dalë të peshkojnë. Njëri prej tyre hëngri peshkun e ndaluar. Nga zemërimi, Dielli-grua krijoi një shkulmë uji që e ngriti në qiell kanoen bashkë me tre vëllezërit.

Një histori shumë e ndryshme tregohet nga indianët e Brazilit: Konstelacioni i Burrit Plak paraqet një burrë, gruaja e të cilit i pëlqente të vëllanë. Prandaj ajo vrau burrin e vet dhe ia preu njërën këmbë. Zotat ndjenë dhimbje për të dhe e shndërruan në një konstelacion.

Një mozaik i shek.6 që paraqet rrotën e zodiakut me motive greke.

Zodiaku kinez, shumë i ndryshëm nga zodiaku oksidental.

Astronomia dhe Astrologjia

Fjala zodiak është shumë e njohur, për arsye të lidhjes së saj me horoskopin, që pretendon të parashikojë të ardhmen e njeriut bazuar në pozicionin e Diellit në zodiak, në ditën e tij të lindjes. Njerëzit që shkruajnë horoskopin quhen Astrologë dhe nuk duhen ngatërruar me Astronomët.

Astronomia është një shkencë që përshkruan dhe përpiqet të kuptojë objektet përtej atmosferës së Tokës (planete, yje, galaksi). Astrologjia nuk është shkencë. Ajo supozon se ka një lidhje mes pozicioneve të Diellit e planeteve dhe jetës së njerëzve. Por nuk ka asnjë arsye që kjo të jetë e vërtetë. Në fakt, shumë prova dëshmojnë të kundërtën.



Konstelacioni i Orionit, i parë nga hemisfera e jugut, d.m.th. « kokëposhtë ».

I është mbivendosur shenja e mitit që një nga popujt e Australisë e lidh me këtë konstelacion.



Burri Plak është emri indigjen brazilian i konstelacioni t të formuar nga kombinimi i konstelacione ve të Orionit dhe të Demit. (Imazh nga muzeu i Amazonisë.)

Ky vizatim 17,000 vjeçar në shpellën Lascaux, në Francë, tregon vjet e asaj që sot quhet grupi i Plejadave.

Ky diskë i gjetur në Gjermani dhe që mendohet të jetë bërë rreth 4000 vjet më parë, tregon Diellin, Hënën dhe shumë yje, ndërmjet të cilave dhe Plejadat.

Një natë me yje mbi Rhône' është piktura e famshme e artistit të madh hollandez Vincent Van Goqh, ku mund të shihet

Konstelacioni i Arushës së Madhe.

Binjakët, në një kopje persiane të vitit 1537 të librit « Merekulitë e Krijimit »-shkruar nga, al-Qazwini

Luani, në librin «Uranometria» të astronomit gjerman Johan Bayer (1603).

Akrepi, në Traktatine Sferave, të Andalo di Negro nëth 1330.

Mjelma, në Atlasin Qiellor të astronomit anglez John Flamsteed (1729).

Ky mnnilibër është shkruar në 2015 nga Grazyna Stasiska e Observatorit të Paristë (Francë). Është përkthyer në shqip nga Mimoza Hafizi e Universitetit të Tiranës.

Universi në xhepin tim No. 5

Kapaku i përpunë tregon "Emu në qiell", një konstelacion i pranishëm në shumë kultura aborigjene australiane. Ai nuk përcaktohet nga yjet, por nga njollat e errëta, që duken mbi sfondin e Rrugës së Qumështit.

Vizitoni faqen http://www.tuimp.org për të mësuar më shumë përkëtë sen dhe përtemat e paraqitura në minilibër.

TUIMP Creative Commons CC BY NC SA

Nëse shikoni qiellin në një natë të pastër, do të vëreni seesi yjet duket sikur formojnë figura.

Këto figura, të quajtura konstelacione, e njajnë formën e tyre gjatë gjithë natës dhe madje nuk ndryshojnë as nga nata në natë. Por i gjithë motivi zhvendoset: ashtu si dhe Dielli, konstelacionet « indian » në Lindje dhe « perëndojnë » në Perëndim. I gjithë motivi ndryshon gradualisht vend nga njëra natë tek tjetra, por vjen saktësisht në të njëjtin vend një vit më pas.

Nuk është për t'u çuditur se edhe në kohërat e vjetra, popujt e të gjitha kulturave i kanë kushtuar vëmendje të veçantë qiellit, që i ndihmonte të orientohesin si në hapësirë, astu dhe në kohë.

Kështu nisi Astronomia.